



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2023:141826

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05525409

C.nr.912/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses A Du nga Gj, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fadil Sinanaj avokat nga Gjilani, kundër të paditurës The N U L.L.C me seli në P, Rr., me objekt kontesti pagesa e borxhit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 19.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia e paditëses A D nga Gj, e parashtruar kundër të paditurës The N U L.L.C me seli në P, pa nr., me objekt kontesti pagesa e borxhit, me vlerë të kontestit 748.8 euro.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 26.06.2023 ka parashtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurrës për pagesën e borxhit, me vlerë të kontestit prej 748.8 euro.

Gjykata, me aktvendimin e kësaj lënde të datës 30.01.2024 ka urdhëruar të autorizuarin e paditëses të dorëzoj gjykatës padinë e plotësuar me adresën e saktë të të paditurës, në mënyrë që gjykata të vendosë lidhur me kërkespadinë, me pasojat procedurale se do të konsiderohet e tërhequr padia nëse nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor (3 ditë), ndërsa nëse i kthehet e pa korrigjuar, gjegjësisht e e pa plotësuar do të hedhet poshtë.

Nga shkresat e lëndës ekziston prova, përkatësisht fletëdërgesa për dorëzim personal, në të cilën shihet se i autorizuari i paditëses më datë 02.02.2024, e ka pranuar aktvendimin e lartëcekur, ndërsa padinë nuk e ka plotësuar, përkatësisht gjykatës përmes parashtrësës së datës 09.02.2024 nuk e ka korrigjuar adresën e të paditurës.

Me nenin 102, parag. 3 të LPK-së është paraparë se “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hedhet poshtë”.

Në këtë kuptim, gjykata gjeti se i autorizuari i paditëses nuk ka vepruar sipas aktvendimit për plotësim të padisë dhe bazuar në nenin 102, paragraf 3 të LPK-së, e njëjta hedhet poshtë si në këtë dispozitiv.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
C.nr.912/2023, me datë 19.03.2024

Gjyqtarja,  
Florije Qerimi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.